



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

## Study program **Gjuhë, kulturë dhe letërsi shqipe (2018/2019)**

Fakulteti	Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimi
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	180 / 240
Kodi	N-ALB
Titulli	Profesor i gjuhës, kulturës dhe letërsisë shqipe
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-5/4
Numri në arkiv i akreditimit [240]	03-807/8 (12.07.2018)
Vendimi për fillim me punë	03-807/8 (12.07.2018)
Data akreditimit	22.01.2018

## Përshkrimi i programit

Programi studimor është përpiluar duke pasur parasysh që studentëve t'u ofrohet qasje në fushën e gjuhës dhe të letërsisë duke u mbështetur gjithmonë në atë që është aktuale në këto fusha studimi.

Njëkohësisht, studentët kanë mundësinë e pajisjes me njohuri më të gjera duke pasur parasysh llojlojshmërinë e lëndëve që ofrohen.

Lëndët të cilat janë përfshirë në këtë program paraqesin perspektiva të cilat bazohen në teori që është e lidhur ngushtë me aplikimin praktik në botën e gjuhës, kulturës, artit, arsimit dhe komunikimit.

Qëllimet kryesore janë:

- T'i përgatisë studentët për pozitën e liderëve në sipërmarrjet dhe organizatat arsimore, kulturore, shkencore në vend dhe gjithkund në botë.
- T'i përgatisë studentët për ndërtim të karrierës në fushën e profesionit të tyre, në sektorin shtetëror, privat dhe joqeveritar.
- Të ofrojë një mori modulesh të cilët e përfshijnë bazën e dijenive dhe për afrimin kah profesionet, të cilat më pak ose më shumë janë të ndërlidhura me sferën e arsimit dhe kulturës dhe mësimdhënies.
- Të mundësojë përfitimin e aftësive hulumtuese në sfera të gjuhës dhe të letërsisë,
- Të mundësojë që të fitojnë përvojë për gjuhësore dhe letrare dhe të njëjtat t'i aplikojë në organizatat publike, private dhe në organizata tjera.
- Ta zhvillojë konceptin e të menduarit kritik të studentëve.
- Të mundësojë që studentët në mënyrë aktive të kyçen në ligjëratat dhe të kryejnë hulumtim të pavarur në të gjitha sferat e organizatave shoqërore, arsimore, kulturore dhe shkencore.
- Të mundësojë zhvillim të aftësive personale, të komunikimit, të hulumtimit dhe të aftësive të tjera të rëndësishme të cilat janë të nevojshme për punësim.

## Karriera

Të diplomuarit e suksesshëm të programit Gjuhë, kulturë dhe letërsi shqipe vazhdojnë në plotësimin e kritereve të tyre

profesionale, në shumë fusha të ndryshme të punësimit. Qëllimi ynë kryesor është përgatitja e mësimitdhënësve të gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe të të gjithë atyre që përfundojnë dhe diplomohen për gjuhë dhe letërsi shqipe në UEJLme sukses të mirë do të kenë potencial të bëhen arsimtarë të mirë të gjuhës, kulturës dhe letërsisë shqipe. Megjithatë, programi ynë për studime deridiplomike nuk përqendrohet vetëm në aspektin gjuhësor. Ne gjithashtu përgatisim edhe profesionistë dhe hulumtues të letërsisë dhe kulturës shqipe. Të diplomuarit do të kenë mundësinë që bazuar në njohuritë e fituara të jenë të përgatitur për tregun e punës. Në fakt, elementet gjuhësore, sociale, kulturore, historike dhe artistike, që përbëjnë fushën e albanologjisë, nënkuptojnë që të diplomuarit tanë janë të përgatitur mirë për të shërbyer si mësimitdhënës, përkthyes, gjuhëtarë të korporatave, shkrimtarë, studiues, gazetarë etj.

## **Rezultatet e të mësuarit**

### **Njohuritë dhe të kuptuarit**

Fiton njohuri të përgjithshme nga fusha e gjuhës, letërsisë, metodologjisë dhe përkthimit. Nga fusha e gjuhësisë fiton njohuri themelore për dialektet, strukturën gjuhësore, normat letrare, vendin e gjuhës në shoqëri, kontaktet me gjuhët tjera dhe historinë e gjuhëve.

Nga fusha e letërsisë fiton njohuri të përgjithshme për letërsinë gojore, teorinë e letërsisë, zhanret dhe drejtimet letrare, si dhe periudhat letrare që nga letërsia e vjetër deri te letërsia bashkëkohore. Njoftohet me metodat më bashkëkohore dhe me strategji për mësimitdhënie dhe komunikim verbal. Pajiset me njohuri themelore për stilet e gjuhës, semantikën dhe llojet e përkthimit.

### **Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit**

Mund të aplikohen në shumë institucione publike dhe shtetërore, në mësimitdhënie, duke punuar si mësimitdhënës dhe profesorë në shkolla fillore dhe të mesme. Njohuritë nga fusha e gjuhës dhe letërsisë mund t'i përdorin për hulumtime në institutet e albanologjisë; për të shkruar tekste të zhanreve të ndryshme, në gazetari; për redaktim të gazetave dhe librave të ndryshëm në shtëpi dhe institucione botuese; për redaktim të teksteve në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe çdo lloj teksti, të çfarëdo lloj stili; për përkthim simultan në institucione private dhe shtetërore, siç janë: komunat dygjuhësore, ministritë dhe institucionet tjera qeveritare, në gjyqë dhe në institucione tjera të ngjashme, në organizatat profesionale, në sektorin publik dhe privat, në organizatat ndërkombëtare dhe të tjera, për përkthime të teksteve, etj.

### **Aftësitë për të vlerësuar**

Ka aftësi të përpilujë dhe të vlerësojë plane dhe programe mësimore nga fusha e gjuhës dhe letërsisë në shkollat fillore dhe të mesme. Ka aftësi t'i vlerësojë dhe t'i krahasojë përkthimet nga një gjuhë në tjetrën; Mund ta vlerësojë lektorimin dhe redaktimin e teksteve të ndryshme letrare, gjuhësore dhe gazetareske, duke vlerësuar shkallën e lartë të lektorimit, duke i gjetur gabimet gjuhësore eventuale. Mund të vlerësojë edhe vepra nga aspekti i përmbajtjes dhe kompozicionit, duke i theksuar vlerat kulturore dhe artistike të veprës. Mund të jetë i zgjedhur në ndonjë juri profesionale nga fusha e gjuhësisë, folklorit dhe letërsisë shqiptare, për vlerësim të hulumtimeve gjuhësore, për poezi, tregim dhe dramë më të mirë, etj. Është i aftë të inkuadrohet në ekipe hulumtuese, të hartojë lista për zgjedhje të lekturave sipas moshës, etj.

### **Aftësitë e komunikimit**

Ka aftësi për të përpiluar dhe vlerësuar plane dhe programe mësimore nga fusha e gjuhës dhe letërsisë në shkollat fillore dhe të mesme. Ka aftësi t'i vlerësojë dhe t'i krahasojë përkthimet nga një gjuhë në tjetrën; mund ta vlerësojë lektorimin dhe redaktimin e teksteve të ndryshme letrare, gjuhësore dhe gazetareske, duke vlerësuar shkallën e lartë të lektorimit, duke i gjetur gabimet gjuhësore eventuale. Mund të vlerësojë edhe vepra nga aspekti i përmbajtjes së kompozicionit, duke realizuar qasje kritike ndaj të njëjtave dhe duke i ndarë vlerat kulturore dhe artistike të veprës. Mund të jetë i zgjedhur në ndonjë juri profesionale nga fusha e gjuhësisë, folklorit dhe letërsisë shqiptare, për vlerësim të hulumtimeve gjuhësore, për poezi, tregim dhe dramë më të mirë, etj. Është i aftë për t'u kyçur në ekipe hulumtuese, të hartojë lista për zgjedhje të lekturave sipas moshës, etj.

### **Aftësitë e të mësuarit**

Posedon shkathtësi për mbajtje të orës mësimore nga gramatika dhe letërsia, në pajtim me programet mësimore për shkollat fillore dhe të mesme. Mund të përkthejë tekste shkencore dhe letërsi artistike nga gjuhët në kontakt, në gjuhën amtare dhe anasjelltas. Mund të marrë pjesë në diskutime shkencore nëpër seminare, që të avancohet me risitë në gjuhë, letërsi, mësimitdhënie dhe përkthim. Mund të shkruajë recensione për programet dhe tekstet mësimore, për ndonjë pjesë teatrale ose për vepra letrare, kryesisht poezi dhe romane. Ka aftësi profesionale për të zgjedhur lektura sipas moshës dhe klasës. Mund të jetë zëdhënës për ndonjë parti politike ose në ndonjë institucion publik ose privat.

# Lista e lëndëve

## Semestri 1

- [CAL-105] [6.0 SETK] **Letërsi popullore**
- [CAL-104] [6.0 SETK] **Fonetika dhe fonologjia 1**
- [CAL-103] [6.0 SETK] **Dialektologjia 1**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë shqipe/maqedonase**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

## Semestri 2

- [CAL-204] [6.0 SETK] **Fonetika dhe fonologjia 2**
- [CAL-202] [6.0 SETK] **Dialektologjia 2**
- [CAL-205] [6.0 SETK] **Historia e letërsisë së vjetër shqipe**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë shqipe/maqedonase**

## Semestri 3

- [CAL-302] [6.0 SETK] **Morfologjia 1**
- [CAL-304] [6.0 SETK] **Letërsia shqipe e Rilindjes 1**
- [EAL-501] [6.0 SETK] **Leksikologjia dhe semantika 1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze për qëllime specifike 1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

## Semestri 4

- [CAL-402] [6.0 SETK] **Morfologjia 2**
- [CAL-404] [6.0 SETK] **Letërsia shqipe e Rilindjes 2**
- [EAL-601] [6.0 SETK] **Leksikologjia dhe semantika 2**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze për qëllime specifike 2**

## Semestri 5

- [EAL-502] [6.0 SETK] **Sintaksa 1**
- [CAL-50] [6.0 SETK] **Letërsia shqipe pas Pavarësisë**
- [CAL-505] [6.0 SETK] **Metodika e gjuhës shqipe**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

## Semestri 6

- [EAL-602] [6.0 SETK] **Sintaksa 2**
- [CAL-603] [6.0 SETK] **Letërsia bashkëkohore shqipe**
- [LCC-601] [6.0 SETK] **Punim diplome**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

## Semestri 7

- [EAL-303] [6.0 SETK] **Gjuhësi e përgjithshme**
- [CAL-701] [6.0 SETK] **Vështrim mbi letërsinë botërore**
- [CAL-702] [6.0 SETK] **Stilistika dhe pragmatika**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

## Semestri 8

- [CTAM1050] [6.0 SETK] **Gjuhësi ballkanike**
- [CTTA70] [6.0 SETK] **Histori e gjuhës shqipe**
- [CAL-801] [6.0 SETK] **Letërsi krahasimtare**
- [LCC-802] [6.0 SETK] **Projekt - Rast studimor**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

## Description of courses

### Lëndë obligative

- **Letërsi popullore**

Qëllimet e lëndës: - Të njihen me letërsinë popullore si dhe me përmbajtjen e lëndës, - Aftësim i studentëve për hetueshmëri të karakteristikave dhe gjinive letrare, - Të njihen me vargun dhe poetikën e letërsisë gojore, - Të aftësohen për analizë të krijimeve popullore si dhe të aftësohen për të bërë dallimin e kohës së paraqitjes dhe shtrirjes së kësaj letërsie.

- **Fonetika dhe fonologjia 1**

Qëllimet e lëndës: - Të fitojnë njohuri të përgjithshme nga fusha e gjuhësisë, fonetikës dhe fonologjisë së gjuhës shqipe: metodologjia dhe studimi i vlerave të larta të kulturës gjuhësore. - Të fitohen njohuri nga gjuha dhe kultura shqipe të cilat mund t'i përdorin për hulumtime nëpër institutet albanologjike; - Të fitojnë shkathtësi për të hartuar njohuri të ndryshme kulturore, tekste dhe monografi mbi komentimin e veprimtarisë gjuhësore, njohjen me dorëshkrimin dhe standardin e gjuhës, lëvizjen historike deri në krijimin final të gjuhës standarde; - Të fitojnë njohuri themelore mbi fonetikën dhe fonologjinë e shqipes nëpërmjet prezantimit shkencorë dinjitoz të gjithë materialit duke aplikuar metodat dhe strategjitë më bashkëkohore (format akustike dhe vizuale), si dhe me komunikim verbal.

- **Dialektologjia 1**

Në lëndën e dialektologjisë, përveç njohurive të përgjithshme mbi rëndësinë e dialektologjisë si shkencë, studiohet edhe klasifikimi i dialekteve dhe karakteristikat e tyre në të gjitha vendet ku jetojnë shqiptarët, duke u bazuar edhe në të folmet e diasporës. Gjeografia gjuhësore, tiparet dalluese fonetike, morfologjike dhe sintaksore të të folmeve përkatëse. Njohja me dialektet dhe veçoritë karakteristike të dialekteve të shqipes në të gjitha rajonet ku jetojnë shqiptarët. Zhvillimi historik i dialekteve, Ndarja dialektore e gjuhës shqipe, dialektet, të folmet kalimtare, nëndialektet, grupet e të folmeve, histori e degëzimit dialektor të gjuhës shqipe nga aspekti fonetik, morfologjik, sintaksor leksikor dhe frazeologjik; si dhe të karakteristikave tjera të studimit të dialekteve, nëndialekteve të gjuhës shqipe.

- **Fonetika dhe fonologjia 2**

Qëllimet e lëndës: - Vazhdim i lëndës fonetika I, fonologjia; - Të mësojnë tingujt dhe fonemat e gjuhës shqipe standarde; - Të mësojnë artikullimin e tingujve dhe ndarjen në bazë të pjesëmarrjes së organeve të të folurit; - Të mësojnë ndarje e shkronjave (zanore dhe bashkëtingëllore); - Theksi në gjuhën shqipe; - Rrokjet dhe llojet e rrokjeve në gjuhën shqipe (të hapura dhe të mbyllura).

- **Dialektologjia 2**

Studentët do të njihen me: - Transkripcionin dialektologjik, shenjat për shkrimin e fonemave. - Zhvillimin historik të dialekteve. - Tiparet dalluese fonetike dhe gramatikore. - Përshkrimet sinkronike dhe diakronike të dialekteve. - Marrëdhëniet e dialekteve me gjuhën letrare. - Tiparet dalluese dialektore që hyjnë në gjuhën letrare për pasurimin, pastrimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të saj, si dhe raporti i dialektit me gjuhën letrare. - Formacionet shoqërore që ndikojnë në ndarjen e gjuhës. - Do të studiohen në mënyrë të posaçme të folmet e diasporës së vjetër, siç janë: e folmja e arbëreshëve të Italisë, Greqisë, Ukrainës, Zarës etj., të cilët kanë ruajtur forma arkaike të gjuhës shqipe dhe janë me interes për dialektologjinë shqiptare.

- **Historia e letërsisë së vjetër shqipe**

Qëllimet e lëndës: - Të njihen me fillimin e letërsisë së vjetër shqipe; - Të njihen me natyrën e temave dhe motiveve të letërsisë së vjetër; - Të njihen me gjuhën dhe stilin e shkrimeve të kësaj periudhe; - Të fitojnë njohuri për veprat dhe autorët më eminentë të kësaj periudhe deri në periudhën e Rilindjes kombëtare; - Të fitojnë njohuri dhe të aftësohen

për njohjen e ngjarjeve shoqërore dhe kulturore në të cilën zhvillohej kjo letërsi.

- **Morfologjia 1**

Qëllimet e lëndës: - Studentët të fitojnë njohuri të përgjithshme nga fusha e gjuhës, konkretisht nga fusha e morfologjisë, të njihen me morfemat e gjuhës shqipe; - Ta përvetësojnë metodologjinë dhe studimin e vlerave të mëdha të kulturës gjuhësore në fushën e fjalës dhe përmbajtjes së saj; - Të njoftohen me historikun e gjuhës dhe kulturës shqipe, duke fituar njohuri themelore mbi morfemat, nocionet themelore si: emri, mbiemri, përemri, ndajfolje, etj; - Studentët të njihen me rolin e fjalës dhe lidhshmërinë e saj në fjali dhe periudhë; - Të aftësohen me format dhe metodat më bashkëkohore, mësohen nocionet si: emra, mbiemra, deri te kategoritë e palakueshme siç janë: lidhëzat, pasthirrat, pjesëzat etj, që u jep studentëve një pasqyrë të qartë për gjuhën dhe për një komunikim më të mirë.

- **Letërsia shqipe e Rilindjes 1**

Qëllimi i lëndës është që studentët: - Të njihen me karakteristikat e përgjithshme të periudhës së Rilindjes kombëtare; - Të njihen me romantizmin dhe me letërsinë artistike të kohës, në veçanti me atë artistike; - Të fitojnë njohuri për njohjen e karakteristikave të përgjithshme të letërsisë së kësaj periudhe; - Të fitojnë njohuri për ndikimin e iluminizmit si dhe të romantizmit evropian në letërsinë shqipe të periudhës së Rilindjes; - Të njihen me zhvillimin dhe veprimtarinë e romantizmit të kolonisë arbëreshe; - Të njihen me vargun shqiptar, zhanrin dhe poetikën letrare në këtë periudhë të letërsisë shqiptare.

- **Leksikologjia dhe semantika 1**

Në këtë lëndë shqyrtohen veçoritë, zhvillimi historik dhe vlerat e fjalëve në gjuhën shqipe. Semantika leksikore e gjuhës shqipe: rrugët e formimit të saj dhe konceptimi i sistemit në semantikë. Kategoritë themelore të semantikës: kuptimi leksikor e lëvizja kuptimore, strukturat e kuptimit leksikor, teoria e fushave leksikore e semantike. Dukuri të semantikës leksikore: prejardhja e kuptimeve leksikore në gjuhën shqipe, ngjyrimi emocional si përbërës i kuptimit, lëvizjet kuptimore dhe tropet gjuhësore. Lëvizjet kuptimore gjatë formimit të fjalëve. Tipat dhe shpjegimi i kuptimit leksikor.

- **Morfologjia 2**

Qëllimet e lëndës: - Vazhdimi i lëndës morfologjia I; - Njohuritë e fituara nga kursi paraprak duhet t'i aplikojnë në këtë kurs; - Grupet e fjalëve/togfjalëshat; - Ndarja morfologjike e fjalëve (pjesë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratës); - Fjalë të ndryshueshme (emri, mbiemri, përemri, folja, numri); - Fjalë të pandryshueshme (ndajfolja, pjesëza, lidhëza, pasthirrma).

- **Letërsia shqipe e Rilindjes 2**

Qëllimet e lëndës janë që studentët: - Të njihen me krijimtarinë e autorëve të periudhës së letërsisë së Rilindjes; - Të njihen me zhvillimin e rrethanave kulturore dhe shoqërore të letërsisë në veçanti; - Të fitojnë aftësi për analizën e relacionit tekst-kontekst; - Të aftësohen për analizë krahasimtare; - T'i ndërlidhin dituritë e fituara me terminologjinë teoriko-letrare; - Të nxiten shkathësitë për nxënie të letërsisë së romantizmit në kontekst me letërsinë në përgjithësi.

- **Leksikologjia dhe semantika 2**

Në pjesën e dytë të programit janë përfshirë: homonimet, sinonimet dhe antonimet në gjuhën shqipe. Grupe paradigmatisht fjalësh sipas ndërtimit e kuptimit: fjali të formuara me ndajshuesha e pa ndajshuesha, fjali të formuara me përbërje dhe me përngjitje. Vend i posaçëm i jepet frazeologjisë së gjuhës shqipe: fjala, togfjalëshi dhe njësi frazeologjike, klasifikimi e përdorimi i njësive frazeologjike në ligjërim. Shtresimi i leksikut të shqipes sipas burimit e sipas përdorimit. Leksiku i gjuhës letrare shqipe. Zhvillimi i leksikografisë shqipe, duke u njohur me historikun e botimit të fjalorëve, klasifikimi i fjalorëve dhe puna teorike dhe praktike në hartimin e fjalorëve.

- **Sintaksa 1**

Qëllimi i lëndës është t'i aftësojë studentët për përdorimin e drejtë të fjalëve në periudhë, respektivisht t'i mësojë studentët mbi kombinimet, nga njësitë më të vogla deri te më të mëdhatë. Nëpërmjet kësaj lënde studentët pajisen me njohuri mbi përdorimin e drejtë të gjuhës shqipe në përputhje me normën gjuhësore në sferat e ndryshme të jetës shoqërore, si pedagogë të ardhshëm të gjuhës shqipe në shkolla dhe institucione tjera arsimore. Gjithashtu këto njohuri përbëjnë bazë në zgjerimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive gjuhësore në përgjithësi.

- **Letërsia shqipe pas Pavarësisë**

Qëllimet e lëndës: - Të njihen me letërsinë pas Pavarësisë; - Të njihen me përfaqësuesit e kësaj letërsie; - T'i shkoqisin poezitë e përfaqësuesve me eminentë të kësaj periudhe; - T'i shkoqisin romanet e përfaqësuesve më të

rinj të kësaj periudhe; - T'i shkoqisin dukuritë teorike-kritike të autorëve të letërsisë së pas Pavarësisë.

- **Metodika e gjuhës shqipe**

Metodika e gjuhës amtare u mundëson studentëve, t'i bartin në mënyrë më praktike njohuritë e përgjithshme për gjuhën dhe letërsinë shqipe te studenti apo nxënësi. E gjithë kjo si lëmi ka për qëllim që njohuritë e fituara studentët të mund t'ua përcjellin gjeneratave të ardhshme duke e zbatuar këtë në praktikë edhe tek nxënësit e studentët. Format e tanishme të mësimdhënies i mundësojnë secilit që ta përcjellë dijen me format më bashkëkohore të punës të cilat janë paraparë në didaktikën bashkëkohore. Këtu nuk është qëllimi që të përfshihen format e vjetra të punës, por studentët të njihen tërësisht me metodologjinë e re të punës për mësimdhënie e mësimnxënie, përmes video-filmave, internetit, përdorimit të mjeteve teknologjike bashkëkohore si: FB dhe Classroom nepërmjet të cilëve studentët kanë qasje për detyrat, pyetjet dhe njëkohësisht japin përgjigjen e njohurive të fituara nga format me efikasë të sotme për mësimdhënie e gjuhës dhe kulturës dhe letërsisë shqipe.

- **Sintaksa 2**

Qëllimi i lëndës është që studentët t'i mësojnë llojet e lidhjes së fjalëve në fjali të thjeshta dhe te përbëra. Gjithashtu, në kuadër të lëndës studentët i mësojnë llojet e lidhjeve të fjalive në mes vetes, si: fjali me nënrenditje dhe bashkërenditje, llojet e tyre. Po ashtu, studentët i fitojnë njohuritë adekuate mbi përdorimin e drejtë të të folurit dhe të të shkruarit, rëndësinë mbi formimin dhe përdorimin e drejtë të fjalive të përbëra, pra formulimin e paragrafëve në tekst. Lënda përmbillet me përdorimin adekuat të ligjëratës së drejtë dhe të zhdrejtë.

- **Letërsia bashkëkohore shqipe**

Qëllimet e lëndës: - Të njihen me rrethanat dhe kohën kur është paraqitur letërsia bashkëkohore; - Të njihen me karakteristikat e stileve, llojeve dhe gjinive letrare; - Të njihen me përfaqësuesit si dhe me krijimet e tyre letrare; - Të fitojnë aftësi për analizë të teksteve konkrete; - Të fitojnë aftësi për qasje krahasuese dhe aftësi për analizë të relacionit tekst - kontekst.

- **Punim diplome**

Ky është një aktivitet lidhur me punimin e diplomës dhe projekt profesional. Nga studentët kërkohet ta shkruajnë një projekt që zakonisht lidhet me punën e diplomës, të punohet struktura e projektit, të bëhet një hulumtim dhe të shkruhet raporti.

- **Gjuhësi e përgjithshme**

Qëllimi i lëndës gjuhësi e përgjithshme është që studentët të njihen me: - gjuhësinë si disiplinë shkencore - si kornizë teorike për hulumtimet gjuhësore; - fillimet dhe historikun e gjuhësisë si shkencë; - kontributin e shkollave lingvistike për gjuhësinë e përgjithshme; - përfaqësuesit kryesorë të këtyre shkollave;

- **Vështrim mbi letërsinë botërore**

Qëllimet e lëndës: - Të njihen me arritjet më të mëdha në letërsinë botërore si dhe me aplikimin e njohurive teorike në tekstet konkrete - Të njihen me periodizimin dhe klasifikimin e letërsisë botërore (zhanret, përfaqësuesit, karakteristikat); - Të njihen me shembujt nga letërsia botërore shikuar nga këndvështimi teorik dhe me mundësinë e aplikimit në veprat letrare; - Ta zhvillojnë aftësinë për krahasim kontrasti të periudhave kryesore dhe autorëve eminentë.

- **Stilistika dhe pragmatika**

Qëllimi i lëndës është që studentët të njihen me veçoritë e specifikuara të gjuhës e stilit. Meqë gjuha është një mjet që shërben për komunikim; ajo ka për qëllim që në sistemin e saj të vërë në disponim mjete si: morfema, tinguj, fjalë, togfjasha etj., të cilët realizojnë një mënyrë të komunikimit të mirëfilltë. Ky është edhe qëllimi kryesor në të cilin sistemi i sotëm i komunikimit nxjerr në sipërfaqe elemente, të cilat e zbukurojnë dhe e specifikojnë gjuhën e folësit. E gjithë kjo e bën të aftë studentin për të komunikuar e për t'u dalluar nga folësit e gjuhës së rëndomtë. Pra, qëllimi i kësaj materie është organizimi i varieteteve gjuhësore të shprehura në tekste të ndryshme.

- **Gjuhësi ballkanike**

Në gjuhësinë bashkëkohore nga fillimi i shekullit XX, interes të veçantë tërhoqi Lidhja e gjuhëve ballkanike. Gjuhët që bëjnë pjesë në këtë Lidhje ballkanike të gjuhëve kanë zhvilluar një sistem të dukurive të përbashkëta (pra jo përputhje të rastësishme) të cilat janë quajtur si ballkanizma. Që një dukuri gjuhësore të quhet ballkanizëm, duhet ta ketë në më së paku 2 deri 3 gjuhë ballkanike. Dukuri të tilla të përputhshme ka në të gjitha rrafshet gramatikore, si ato: fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore.

- **Histori e gjuhës shqipe**

Lënda përfshin një pjesë të madhe të programit nga historia e shkrimit të gjuhës, kulturës dhe letërsisë shqipe. Këtu janë paraparë informata të hollësishme për alfabetin e gjuhës shqipe, rrugë kjo që ishte e gjatë dhe e vështirë, por që solli si rezultat realizimin e shkrimit të gjuhës shqipe me alfabetin aktual. Studentët do të mësojnë pjesë që nga koha e Mesjetës e deri më sot. Studentët do të njihen me historinë e gjuhës shqipe, alfabetin dhe rrjedhat bashkëkohore të sukseseve të arritura në fushën e gjuhësisë dhe kulturës shqipe.

- **Letërsi krahasimtare**

Qëllimi i lëndës është njoftimi i studentëve me konceptet krahasuese, si dhe me zhvillimin aktual të letërsisë së sotme përgjithësisht. Përmes këtij programi, studentët do të njoftohen me mënyrat krahasimtare të letërsisë së sotme shqipe (autorëve shqiptarë), me letërsinë e popujve të tjerë në konotacion krahasimtar. Me këtë do të mësohen që ta shikojnë një vepër në këndvështrim kritikë me qëllim të perfeksionimit në veprimtari kritike.

## Lëndë zgjedhore

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1**

Pas përfundimit të lëndës gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1, nga studentët pritet t'i zgjerojnë dhe t'i forcojnë aftësitë e tyre për shprehje më të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e mjedisve të ndryshme profesionale. Studentët pritet të jenë në gjendje të lexojnë, të shkruajnë dhe të kuptojnë tekste të ndryshme profesionale në maqedonisht. Ata gjithashtu pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me terminologjinë e përgjithshme nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhës dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në korniza të profesioneve të tyre të ardhshme. Përveç përmbushjes së këtyre qëllimeve profesionale, studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike në një ambient shumëgjuhësor dhe shumëkulturor.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2**

Pas përfundimit të lëndës gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2, nga studentët pritet t'i rikonfirmojnë dhe t'i zgjerojnë më tej aftësitë e tyre për shprehje të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e profesioneve të tyre të ardhshme. Ata do të jenë në gjendje të lexojnë, shkruajnë dhe të kuptojnë lloje të ndryshme të teksteve profesionale në maqedonisht, të analizojnë dhe t'i diskutojnë këto tekste, si dhe t'i krijojnë dokumentet e tyre, duke përfshirë biografi profesionale në maqedonisht (CV). Ata gjithashtu duhet t'i zgjerojnë njohuritë e terminologjisë specifike nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhëve dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në simulimin e situatave autentike nga mjediset profesionale në debate dhe në shkëmbim mendimesh në lidhje me aspektet e ndryshme të këtyre profesioneve.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 1**

Programi për gjuhën maqedonase për fillestarë përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit. Përmes ushtrimeve dhe ligjëratave të veçanta studentëve u mundësohet ta njohin komunikimin themelor në gjuhën maqedonase, d.m.th, të njoftuarit, përshëndetjet, prezantimin si dhe pasurimin e fondit të fjalëve bashkë me shkrimin dhe kuptimin e teksteve të vogla. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund edhe të zbatohen edhe mëtutje. Materiali përpunohet sipas parimit të ligjëratave dhe ushtrimeve të kombinuara si dhe detyrave të vazhdueshme përmes të cilave studentët përfshihen në mënyrë aktive gjatë orës mësimore duke parashtruar pyetje dhe propozime për mbarëvajtjen e orës.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 2**

Programi për gjuhë maqedonase 2 për fillestarë përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit. Në suaza të kësaj lënde përfshihen gjerat në vijim: detyra të përditshme, planifikimi i aktiviteteve për periudhën e ardhshme, përshkrimi i personave, vendeve dhe lëndëve. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje.

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 1**

Lënda gjuhë shqipe për fillestarë 1 është e përgatitur me qëllim që studentëve të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione) të thjeshta. Edhe pse bëhet fjalë për një kurs të shkallës së dytë për fillestarë, ky është menduar të jetë fleksibil dhe t'u

përshtatet mundësive e interesave të studentëve.

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 2**

Lënda gjuhë shqipe për fillestarë 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të saj, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të zotërojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore, të cilat do ju mundësojnë biseda të thjeshta. Edhe pse bëhet fjalë për kurs të shkallës së dytë për fillestarë, ky është menduar të jetë fleksibil dhe t'u përshtatet mundësive dhe interesave të studentëve.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 1**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 2**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 3**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 4**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze 5**

Anglishtja akademike është lëndë një semestrale e cila ka për qëllim t'u mundësojë studentëve të aftësohen të fitojnë shkathtësi të cilat do t'u lehtësojë mësimin e gjuhës dhe progresin e mësimin të tyre në një mjedis akademik të të mësuarit dhe të nxëniet. Numri i orëve është 30 (100 minuta, një herë në javë). Lënda duhet t'u mundësojë atyre t'i përdorin këto aftësi jo vetëm në gjuhën e huaj (në klasë të gjuhës amtare), por edhe në sferat e përmbytjes. Lënda përfshin aftësitë gjuhësore, aftësitë studimore dhe në përgjithësi aftësitë e zbatueshme (dëgjim, bërje të prezantimeve gojore, ndërtim argumentesh) në detyra të veçanta. Prandaj, pas përfundimit të lëndës studentët duhet të jenë në gjendje të ofrojnë në mënyrë të suksesshme prezantime me gojë, të marrin pjesë në një debat/ diskutim online duke shprehur mendimet dhe argumentet e tyre dhe t'i japin arsyetimet e tyre në mënyrë konstruktive. Përveç



kësaj, studentët duhet të jenë në gjendje ta dëgjojnë dhe ta lexojnë thelbin dhe detajin dhe të shkruajnë një paragraf dhe ese argumentues duke deklaruar mendimin e tyre. Ata duhet të shkruajnë një paragraf dhe ese për zgjidhje të problemit. Duhet t'i njohin shkurtesat dhe simbolet në fjalor si dhe ta praktikojnë përdorimin e fjalorit njëgjuhësor. Ata duhet të jenë në gjendje ta prezantojnë informatën vizuale në formën e prezantimeve afishe. Studentët duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë idetë kryesore dhe të dhënat mbështetëse në një tekst, dhe t'i analizojnë dhe t'i identifikojnë fjalitë e temës në një paragraf. Ata duhet të jenë në gjendje ta identifikojnë qëllimin e një teksti, modelet e organizimit në një tekst dhe t'i zbatojnë ata në shkrimet e tyre.

#### • **Gjuhë angleze 6**

Anglishtja akademike është lëndë një semestrale e cila ka për qëllim t'u mundësojë studentëve të aftësohen të fitojnë shkathtësi të cilat do t'u lehtësojë mësimin e gjuhës dhe progresin e mësimin të tyre në një mjedis akademik të të mësuarit dhe të nxëniet. Numri i orëve është 30 (100 minuta, një herë në javë). Lënda duhet t'u mundësojë atyre t'i përdorin këto aftësi jo vetëm në gjuhën e huaj (në klasë të gjuhës amtare), por edhe në sferat e përmbajtjes. Lënda përfshin aftësitë gjuhësore, aftësitë studimore dhe në përgjithësi aftësitë e zbatueshme (dëgjim, bërje të prezantimeve gojore, ndërtim argumentesh) në detyra të veçanta. Prandaj, pas përfundimit të lëndës studentët duhet të jenë në gjendje të ofrojnë në mënyrë të suksesshme prezantime me gojë, të marrin pjesë në një debat/ diskutim online duke shprehur mendimet dhe argumentet e tyre dhe t'i japin arsyetimet e tyre në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët duhet të jenë në gjendje ta dëgjojnë dhe ta lexojnë thelbin dhe detajin dhe të shkruajnë një paragraf dhe ese argumentues duke deklaruar mendimin e tyre. Ata duhet të shkruajnë një paragraf dhe ese për zgjidhje të problemit. Duhet t'i njohin shkurtesat dhe simbolet në fjalor si dhe ta praktikojnë përdorimin e fjalorit njëgjuhësor. Ata duhet të jenë në gjendje ta prezantojnë informatën vizuale në formën e prezantimeve afishe. Studentët duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë idetë kryesore dhe të dhënat mbështetëse në një tekst, dhe t'i analizojnë dhe t'i identifikojnë fjalitë e temës në një paragraf. Ata duhet të jenë në gjendje ta identifikojnë qëllimin e një teksti, modelet e organizimit në një tekst dhe t'i zbatojnë ata në shkrimet e tyre.

#### • **Të folurit publik**

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të fitojnë njohuri në lidhje me procesin e komunikimit, përgjegjësitë etike të të folurit publik dhe llojet e ndryshme të fjalimeve informative dhe bindëse. Përveç kësaj, studentët do të fitojnë njohuri të nevojshme për përgatitjen dhe dhënien e llojeve të ndryshme të fjalimeve, aftësi për ta analizuar publikun, të gjurmojnë tema për fjalime, të përgatisin fjalime, e të tjera. Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike duke qenë vetëkritikë konstruktivë dhe gjithashtu kritikë ndaj fjalime të kolegëve.

#### • **Debat dhe shkathtësi prezantimi**

Nga kjo lëndë studentët: do të përfitojnë shkathtësi për diskutim dhe argumentim efektiv si dhe do të zhvillojnë vetëbesim për të folur para publikut; do të përpilojnë, do të zhvillojnë dhe do të ushtrojnë prezantimin e argumenteve në mënyra të ndryshme përfshirë punën individuale, në çifte dhe prezantime në grupe; do të mësojnë të përdorin retorikë bindëse, me qëllim të gjetjes së argumenteve që mbështesin një pozitë të caktuar lidhur me temat aktuale; ndjekja e kësaj lënde do t'u mundësojë të njihen në mënyrë më të hollësishme me proceset e debatit formal, gjegjësisht me stilin parlamentar britanik për debate;

#### • **Studime ndërkulturore**

Pasi ta kenë përfunduar lëndën, studentët do të mund t'i identifikojnë çështjet globale dhe problemet nga perspektiva e kulturave të ndryshme, dinamikën e komunikimit në kulturat tjera, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vlerave të tyre dhe ato të kulturave tjera si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e praktikave të komunikimit të tyre dhe të kulturave tjera. Aq më shumë, nga studentët pritet që të bëhen më të vetëdijshëm për stereotipat që shoqëria i ka për kulturat e ndryshme dhe, si pasojë, më mirë do ta kuptojnë vendin e tyre në komunitetin global. Studentët do të fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike mbi tema rreth etnisë së tyre, identitetin gjinor, klasën, fenë, origjinën kombëtare, moshën si dhe karakteristika të tjera demografike dhe ndikimin e tyre në procesin e komunikimit. Pas përfundimit të kursit Studime ndërkulturore studentët do të fitojnë aftësi të komunikuarit të nevojshme për punën në grupe përmes pjesëmarrjes së tyre në hulumtime dhe gjithashtu do të fitojnë aftësi për t'i prezantuar këto projekte kërkimore.

#### • **Aftësitë e komunikimit**

Lënda është dizajnuar t'u mundësojë studentëve që praktikisht ta zbatojnë komunikimin ndërpersonal. Studentët do të mësojnë aftësi ndërpersonale siç janë: perceptimi, të dëgjuarit, komunikimi verbal dhe ai jo verbal; do ta ushtrojnë të folurit publik, si për shembull: organizimin, prezantimin dhe bazat e të shkuarit fjalime publike. Studentët do të kenë mundësinë të praktikojnë komunikimin në grupe të vogla, duke filluar nga: lidhshipi, vetëbesimi dhe të dëgjuarit. Kursi po ashtu ofron njohuri themelore të nevojshme për ta kuptuar procesin e kërkimit të një vendi pune nëpërmjet komunikimit me shkrim dhe me gojë, duke shkruar rezyme, letër motivimi dhe duke simuluar intervista.

- **Excel i avancuar**

Qëllimi i lëndës është që t'i informojë studentët me aplikacionin Microsoft Excel dhe duke shfrytëzuar mundësitë që ofron ky aplikacion të jenë në gjendje të kryejnë detyra të avancuara të cilat janë ngushtë të lidhura me programin fakultativ të tyre.

- **Aftësitë të avancuara të TI-së**

Qëllimet e lëndës janë: T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri themelore dhe aftësi në fushën e shkencave informative dhe t'i njoftojë studentët me mundësitë që ato i ofrojnë; T'i pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike rreth aplikacioneve të Microsoft Office (Windows, Word, PowerPoint, Excel, Access) dhe t'ju mundësojë që këto aplikacione edhe t'i aplikojnë në jetën e përditshme; T'u mundësojë studentëve të punojnë projekte praktike individuale ose në grupe.

- **Word i avancuar**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i pajisë studentët me aftësi të avancuara rreth përdorimit të Word-it dhe PowerPoint-it. Ky kurs gjithashtu u mundëson studentëve që në mënyrë të pavarur të zbatojnë projekte të ndryshme si dhe detyra të veçanta komplekse të cilët janë të lidhura me programin e studimeve të tyre.

- **Google Apps**

Qëllimet e lëndës janë: T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri dhe aftësi të avancuara në fushën e shërbimeve elektronike (cloud applications); T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri teorike dhe praktike rreth Google Docs (G-mail, dokumente, spreadsheets, prezantime, vizatime dhe formulare) dhe t'i aplikojnë ato në jetën e tyre; T'u mundësojë studentëve të punojnë individualisht ose në grupe në projekte të ndryshme drejtpërdrejt nga web browser-i.

- **Access-i i avancuar**

Bazat e të dhënave (databases) janë mjete ideale për ndjekjen e vëllimeve të mëdha. Microsoft Access-i është një mjet mjaft i fuqishëm dhe i popullarizuar i cili përdoret për hartimin dhe zhvillimin e Windows-based databases. Ky kurs është i dizajnuar për përdorues të rinj të Access-it ku janë të përpunuara funksionet e nevojshme për të punuar me bazat e të dhënave.

- **Desktop publikimi**

Qëllimi i kësaj lënde është hartimi dhe përpunimi i grafikave raster dhe vektor përmes programeve kryesore të Adobe Photoshop dhe Illustrator, si dhe hartimi dhe botimi i materialeve komerciale për shtyp duke përdorur Adobe InDesign.

- **Publikimi ueb**

Zhvillimi i një ueb faqeje qoftë edhe e thjeshtë në përputhje me standardet aktuale kërkon njohuri të gjuhës së Hypertext Markup (XHTML) dhe Cascading Style Sheets (CSS). Shumë faqe ueb përdorin imazhe qoftë në formë të banerëve, sustave, logove, fotografive apo skenimeve. Adobe Fireworks është ndërtuar si një mjet për të krijuar dhe manipuluar imazhet e destinuar për ueb dhe për t'iu mundësuar krijuesve që t'i përdorin këto imazhe për të zvogëluar madhësinë e fajllit. Fireworks gjithashtu ofron një integrim të shkëlqyer me Dreamweaver. Kjo seri ofron një hyrje të plotë në XHTML, CSS dhe krijimin e grafikës për ueb.

- **Gjuhë shqipe me kulturë shkrimi**

Lënda Gjuhë shqipe me kulturë shkrimi është një sintezë e rregullave dhe udhëzimeve të cilat janë të parapara për t'i përmirësuar shkathtësitë e të shprehurit me shkrim dhe me gojë në gjuhën shqipe. Përmirësimi i këtyre shkathtësive, para së gjithash, parashihet që të realizohet përmes familjarizimit me rregullat drejtshkrimore dhe disa norma morfologjike e sintaksore të gjuhës shqipe që shihen si të nevojshme që të arrihet përdorimi i drejtë i gjuhës. Më pas, theks i veçantë i kushtohet motivimit të studentëve për ligjërim të rrjedhshëm, rritjes së vetëdijes për përdorimin e gjuhës së pastër dhe standarde shqipe. Gjithashtu, hapësirë të veçantë zë edhe nxitja e vullnetit për përmirësim të procesit të të shkruarit, duke i vetëdijësuar studentët për dallimet e llojeve të teksteve të shkruara, por edhe për vetëdijen për integritet akademik në punimet serioze kërkimore (plagjiaturën), duke mos lënë pas as përfshirjen e terminologjisë specifike të fushave të ndryshme në të cilat janë të orientuara studentët. Të gjitha këto tema janë paraparë që studentëve t'u ofrohen si njësi mësimore të kombinuara, gjegjësisht si rregulla, udhëzime e ushtrime që plotësohen mes veti.

- **Gjuha shqipe për qëllime specifike**

Lënda ka për qëllim përmirësimin dhe përsosjen e të shprehurit në gjuhën shqipe, qoftë me gojë ose me shkrim. Në mënyrë të veçantë lënda ka për qëllim të njoftojë studentët me terminologjinë specifike, mundësitë e përdorimit të saj, me gabimet më të shpeshta në të folurit e përditshëm, por edhe për komunikim në rrethana specifike. Studentët

do të njoftohen me kushtet në të cilat ata rregulla hyn në përdorim , në mënyrë që mund ti përdorin jo vetëm për detyrat në lidhje me këtë temë, por edhe në karrierën e tyre të ardhshme profesionale.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën angleze**

Në këtë lëndë do të zhvillohen shkathtësitë akademike të të shkruarit të studentëve në mënyra të ndryshme. Studentët do të aftësohen t'i komunikojnë idetë e tyre në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe efektive që të prodhojnë një pjesë të shkruar. Gjithashtu, studentët do të njoftohen me rregullat e citimit dhe parafrazimit dhe do të vetëdijësohen se çka është plagjiatura. Informata kthyesë e një pjesë të shkruar do të përfshijë vetëkorrigjimin, korrigjimin e njëri-tjetrit dhe korrigjimin nga ana e mësimitdhënësit të përmbajtjes, organizimit dhe gabimeve gjuhësore gjatë procesit të të shkruarit.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën maqedonase**

Pas mbarimit të kësaj lënde, nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të përshtatshme dhe komunikim të avancuar në gjuhën maqedonase me theks të veçantë në aftësitë e të shkruarit. Pas kësaj, pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm. Për më tepër, studentët do të jenë në gjendje t'i përmirësojnë aftësitë e tyre të të shkruarit në më shumë nivele dhe në këtë mënyrë do të bëhen më të sigurt dhe më kompetentë gjatë të shkruarit në gjuhën maqedonase. Studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin konkludime. Studentët, gjithashtu, do të zhvillojnë aftësi për shkrim dhe komunikim të shkëlqyer në gjuhën maqedonase.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën shqipe**

Në fund të çdo niveli studentët do të jenë në gjendje të shkruajnë ese dhe punime kërkimore bazuar në rregullat e mësuara gjatë ligjëratave. Më konkretisht, nga studentët pritet që t'i mësojnë funksionin, strukturën dhe llojet e ndryshme të paragrafëve, mënyrat se si të zgjedhin tema për punime kërkimore, si të grumbullojnë materiale, rregullat se si t'i dokumentojnë referencat e të arrijnë deri tek modeli përfundimtar.

- **Gjuha gjermane (niveli 1-4)**

Pas përfundimit të çdo niveli nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të duhura në përputhje me Kornizën Evropiane të Gjuhëve (të përcaktuara saktësisht në nivele). Përveç kësaj pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm ndaj mësimit të gjuhës. Deri në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin përfundime. Studentët gjithashtu do të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet dhe opinionet e tyre në formë të shkruar dhe gojarisht në gjuhën gjermane."

- **Mbrojta e ambientit**

Qëllimet e lëndës janë: T'i njoftojë studentët me problemet kryesore të mjedisit; T'i njoftojë studentët me rolin e njeriut si faktor kyç në procesin e ndotjes dhe mbrojtjes së ambientit; T'i njoftojë studentët me ndikimin e ndotësve të ndryshëm të ambientit në shëndetin e njeriut, veprimtarinë profesionale dhe aftësitë organizuese të faktorit njerëzor; Krijimi i shprehive pozitive ndaj ambientit dhe ngritja e vetëdijes për një mjedis më të shëndetshëm dhe më të pastër; Legjislacioni ndërkombëtar dhe kombëtar dhe konventat ndërkombëtare mbi mjedisin; Hyrje në politikat globale kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mjedisit; Mjedi si një kusht për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; Roli i shoqërisë në mbrojtjen e mjedisit; Njoftimi me rreziqet kryesore për një mjedis të shëndetshëm; Njoftimi me Strategjinë kombëtare të mjedisit në Republikën e Maqedonisë.

- **Zhvillimi profesional i karrierës**

Kjo lëndë ofron mësim praktik të orientuar drejt rezultateve për kërkim. Po ashtu lënda i aftëson di ta fitojnë dhe si ta mbajnë vendin e punës. Ka për qëllim që studentëve t'u sigurojë aftësi të përshtatshme për vende pune moderne. Detyrë kryesore do të jetë përpilimi i CV, shkrimi i letrës së interesit/kërkesës, aftësitë për të intervistuar, komunikimi zyrtar në zyrë (memorandume, e-maile oficiale për mbikëqyrësit, konsumatorët, raporte e të tjerë). Elemente shtesë që do t'i përfshijë kjo lëndë janë: si të bëhet vetëvlerësimi, si të menaxhohet konflikti midis dy zyrave dhe si të kërkohet në mënyrë aktive promovimi. Aftësitë e fituara në këtë lëndë do të jene të zbatueshme edhe në procesin e kërkimit të punës në përgjithësi.

- **Liritë dhe të drejtat e njeriut**

Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet historike për t'i identifikuar ato. Me kalimin e kohës, korpusi i të drejtave dhe lirive të njeriut që mbrohen me ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare është zgjeruar, por kjo nuk do të thotë se ato respektohen në praktikë. Në fillim, të drejtat e njeriut konsideroheshin si çështje të mbrendshme të shteteve (sipas parimit të sovranitetit absolut të shtetit) dhe vetëm në kohërat më të reja ato fituan statusin e normave kogente. Kjo lëndë e studion zhvillimin e doktrinës për të drejtat e njeriut, llojet dhe kategoritë e të drejtave të njeriut dhe dokumentet kryesore që i rregullojnë dhe që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Kjo lëndë ka për qëllim: t'i njoftojë studentët me konceptin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, me zbatimin e tyre dhe me ndikimin që ato

kanë në formulimin e politikave kombëtare. Kjo do t'i inkurajojë studentët të reflektojnë në mënyrë kritike mbi raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe të asaj kombëtare, do t'i vetëdijësojë ata për ndryshimet ndërkombëtare në këtë drejtim dhe për mënyrën si këto të drejta ndikojnë në jetën e njerëzve në botë. Dhe do t'i nxisë që të kontirbuojnë në përparimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

- **Gjuhë angleze për administratë publike, shkenca politike dhe komunikim 1**

Anglishtja për administratë publike dhe shkenca politike 1 dhe 2 është lëndë semestrale dhe u dedikohet studentëve nga këto programe studimore. Njëkohësisht, studentët që studiojnë komunikim ndërkombëtar mund ta ndjekin atë. Programi bazohet në përmirësimin dhe përvetësimin e gjuhës angleze në tërësi, përvetësim të një terminologjie të posaçme nga lëndët profesionale të këtyre fushave, zhvillim dhe përmirësim të shkathhtësive akademike të të shkruarit dhe të të lexuarit, si dhe diskutim tekstesh dhe përshkrime nga fusha e administratës publike, shkencave politike si dhe komunikimit dhe raporteve ndërkombëtare. Materialet që përdoren janë nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe tekste nga botues të mëdhenj, si dhe tekste dhe materiale autentike. Theks i veçantë në lëndën në fjalë i kushtohet terminologjisë profesionale për qëllime komunikimi e cila do të jetë e zbatueshme gjatë ndërtimit të karrierës së studentëve.

- **Teoria e letërsisë 1**

Qëllimet e lëndës: - të njihen me teorinë letrare si shkencë, - të aftësohen për përdorimin e nocioneve teorike-letrare, nocione këto të nevojshme për studimin e letërsisë dhe analizën e teksteve letrare; - studentët të njihen me nocionet themelore teorike; - të aftësohen që t'i dallojnë karakteristikat metrike të vargut, të cilat më vonë do të mundën t'i përdorin në analizën e teksteve konkrete; - të aftësohen për analizë të teksteve me nocione teorike; - të njihen me metodologjinë e shekullit XX.

- **Teoria e letërsisë 2**

Qëllimet e lëndës: - të njihen me stilistikën; - të aftësohen me analizën figurative në shembujt konkretë; - të aftësohen me analizë hermeneutike bazuar në terminologjinë teorike; - të njihen me mënyrën e analizës shikuar nga aspekti narativ; - të aftësohen për analizë të teksteve të llojeve dhe gjinive të ndryshme.

- **Sociolinguistika 1**

Në kuadër të lëndës së sociolinguistikës studentët do të njihen me konceptet themelore që kanë të bëjnë me raportin gjuhë dhe shoqëri, gjegjësisht me mënyrën e shfrytëzimit të gjuhës në kontekste të ndryshme shoqërore, si dhe me çështjet kryesore të variateteve gjuhësore. Me këtë lëndë studentët do të njihen me të gjitha dukuritë gjuhësore në një bashkësi shoqërore. Në veçanti do të shyrtohen akti i bisedës dhe vetë akti i komunikimit, si dhe kompetencat komunikative. I rëndësishëm është edhe zhvillimi i sotëm gjuhësor në krahasim me zhvillimin e përgjithshëm kulturor e shoqëror.

- **Sociolinguistika 2**

Në pjesën e dytë do të shqyrtohen disa dukuri sociolinguistike, si: raporti midis gjuhës dhe dialektit, gjuhës dhe planifikimit, përvetësimi i të folurit nga fëmija, përkufizimi i situatave të diglosisë, diasistemit, bilinguizmit etj. Me rëndësi janë edhe studimet për bashkësinë shoqërore në raport me bashkësinë gjuhësore. Individu folës dhe bashkësia folëse. Varieteti gjuhësor. Akti i të folurit dhe akti i komunikimit. Kompetenca komunikative. Ndryshimi gjuhësor. Nivelet e analizës sociolinguistike. Diferencat shoqërore dhe sjellja gjuhësore. Planifikimi gjuhësor. Raste të takimit të shqipes me gjuhët fqinje. Gjuha e diasporës etj.

- **Vlerësimi dhe planifikimi**

Lënda ka për qëllim të bëjë vlerësimin e punës edukative të studentëve dhe nxënësve kur do të filojnë të punojnë në mënyrë aktive me nxënësit-studentët e tyre; Vlerësimi është një hap po ashtu shumë i rëndësishëm, ku ndikojnë shumë faktorë, të cilët mund të sjellin motivimin apo demoralizimin e vetë nxënësit në punën e mëtejshme; Planifikimi është pjesë e përgatitjes me të cilën profesori ose pedagogu mund të orientohe në mënyrën më të mirë të mundshme në raport me atë se si duhet të arrihet një planifikim i suksesshëm, ndërsa pastaj të arrihet edhe realizimi. Në procesin mësimor, është faktorë shumë me rëndësi se si të orijentohen studentët për mënyrën më të mirë të mundshme për planifikimin e një detyre të rëndësishme.

- **Inkluzioni i nxënësve me nevoja të veçanta**

Qëllimi i lëndës është që t'i inkuadrojë të gjithë studentët që në zhvillimin e tyre mund të kenë një shkallë më të lehtë të anomalive mendore apo fiziologjike. Përmes kësaj, MASH ka për qëllim unifikimin dhe përparimin e dijeve për secilin në mënyrë të barabartë, Si qëllim tjetër është që studentët, duke qenë të inkuorporuar së bashku me

mohatarët e tyre, më së miri mund të mësojnë e të përparojnë se sa duke i ndarë në grupe të veçanta. Këta studentë duhet të trajtohen me kujdes të madh dhe të punohet me ta në forma dhe metoda të veçanta. Kjo kategori mund të ketë handicap të shikimit, të dëgjimit, mund të ketë paralizë cerebrale dhe gjithçka çka mund të jetë e caktuar si diagnozë nga mjeku. Integrimi i kësaj kategorie paraqet një risi në procesin e mësimdhënies bashkëkohore.

- **Letërsia për fëmijë**

Цели на предметната програма: - Запознавање со посебните karakteristiki на detската книжевност; - Препознавање на специфичните форми на izrazување кај светската detската книжевност (главните претставници); - Оспособување за препознавање на поврзувањето на читањето со izrazувањето кај децата; - Оспособување за препознавање и почитување на културно-општествените прилики во кои се развива книжевноста за деца; - Стекнување знаења за светската и албанска книжевна за деца; - Развивање vештини за работата врз конкретни tekstovi на книжевноста за деца.

- **Analiza e tekstite dhe kritika letrare**

Qëllimet e lëndës janë: njoftimi i studentëve me materien e analizës themelore të kritikës letrare si fenomen, me terminologjinë themelore dhe zhvillimin e kësaj disipline. Po ashtu studentët njoftohen me ndërveprim komplementar me teorinë e letërsisë, llojet e analizave të bazuara në tekstë të veçanta si dhe të aftësohen për të bërë sintetizime, krahasime dhe analiza konkrete.

- **Gjuhë angleze për administratë publike, shkenca politike dhe komunikim 2**

Anglishtja për administratë publike dhe shkenca politike 1 dhe 2 është lëndë semestrale dhe u dedikohet studentëve nga këto programe studimore. Njëkohësisht, studentët që studiojnë komunikim ndërkombëtar mund ta ndjekin atë. Programi bazohet në përmirësimin dhe përvetësimin e gjuhës angleze në tërësi, përvetësim të një terminologjie të posacme nga lëndët profesionale të këtyre fushave, zhvillim dhe përmirësim të shtathtësive akademike të të shkruarit dhe të të lexuarit, si dhe diskutim tekstesh dhe përshkrime nga fusha e administratës publike, shkencave politike si dhe komunikimit dhe raporteve ndërkombëtare. Materialet që përdoren janë nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe tekstë nga botues të mëdhenj, si dhe tekstë dhe materiale autentike. Theks i veçantë në lëndën në fjalë i kushtohet terminologjisë profesionale për qëllime komunikimi e cila do të jetë e zbatueshme gjatë ndërtimit të karrierës së studentëve.